



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
MUNICIPALITY OF LIPJAN
SKUPŠTINA LIPLJAN

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Në mbështetje të Vendimit të Kryetarit të Komunës të datës 18.02.2022 dhe në përputhje me nenin 20, paragrafin 4 dhe 5 të Ligjit Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, me datën 18.02.2022 shpallë këtë:

NJOFTIM PUBLIK

Me të cilin njoftohen qytetarët e Komunës së Lipjanit për qasje publike në propozimin e objekteve me vlerë natyrore për shpalljen e tyre si “Monumente të natyrës”.

Në kuadër të objekteve me vlerë natyrore të propozuara si “Monumente të natyrës” përfshihen:

1. “Burimet e ujit mineral” në Baicë;
2. “Trungu i Bungëbutës (Quercus pubescens)” në Baicë;
3. “Trungu i Shpardhit (Quercus frainetto)” në Breg të Zi;
4. “Trungu i Bungëbutës (Quercus pubescens)” në Dobrajë të Madhe;
5. “Trungu i Qarrit (Quercus cerris)” në Gadime të Epërme;
6. Mbrojtjen e vlerës së natyrës “Guri te Kroni” në Krojmir;
7. Mbrojtjen e vlerës së natyrës “Trungu i Rrënjës (Quercus robur)” në Poturoc;
8. “Trungu i Qarrit (Quercus cerris)” në Resinoc; dhe
9. “Trungjet e Shpardhit (Quercus frainetto)” në Smallushë.

Në shtojcë të këtij njoftimi i gjeni informatat themelore për secilin objekt të propozuar. Për më shumë informacione mund të kontaktoni drejtpërdrejt zyrtarët e Drejtoratit për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me objektet e propozuara për shpallje si “Monumente natyrore” mund t’i dërgoni në email adresën: hana.berisha@rks-gov.net dhe abetare.rexhepi@rks-gov.net brenda 30 ditëve nga dita e shpalljes së këtij njoftimi.

Pjesëmarrja e juaj i shtonë vlerë procesit të shpalljes së objekteve me vlerë si “Monumente natyrore”.

Lipjan, 18.02.2022

